

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Magic Car Wash" shpk

Në Tiranë, sot më datë 08.09.2022, une **Z. Jurgen Vlashi**, me numer identifikimi J90130043Q, identifikuar me dokument identifikimi: Letërmjofim ID 033989843, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, ne cilësinë e "ortakut themelues" deklaroj se me vullnet të lirë të plotë, mbeshtetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufluar, **"Magic Car Wash" shpk**.

Neni 1
Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin **"Magic Car Wash"**, dhe formë ligjore: "Shoqëri me përgjegjësi të kufluar" (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3
Selia

Shoqëria ka seline në adresën : Zona kadastrale 3866, numër pasurie 315/156, lloj pasurie Are, Yzberish.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Lavazh, larje makinash, larje tapetash, larje tapiceri. Aktivitete te lidhura me sherbim pastrimi ne per gjithesi si: Lavanteri dhe pastrime, pastrime te ambjenteve te perbashketa , pastrime kimike per entet publike dhe private vendase dhe te huaj, Banka, qendra tregtare, spitale, shkolla, konvikte, hotele, restorante, kinema, etj. Veprimitari ne fushen e pastrimit, desinfektimit, deratizimit, te ambjenteve te brendshme dhe te jashtme ne entet publike dhe private. Pastrime, larje, sterilizimi, disinfekte, hekurosje, paketime, dhe administrimit te ketyre veprimtarive per personat fizik e juridik, ente publike etj. Pastime te jashtme dhe te brendshme, ambjentesh si banesa private, zyra, godina sherbimesh spitale, shkolla, qendra tregtare, lokale, hotele. Pastrime mjetesh te levizshme, lavanteri etj. Makina me qera, kafe bar, aksesor makinash, shitje blerje makinash etj. Shoqeria do te ushtroj te gjitha aktivitetet qe parashikon ligji ne fuqi.

Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërise është 10,000 lekë, i ndarë në 1 kuote, i cili zotërohet si më poshtë:

Z.Jurgen Vlashi, zotëron 1 kuotë me vlerë 10,000lekë, e cila përbën 100 % të kapitalit të shoqërisë

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;

- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gi) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9
Administrimi

Administrator i shoqërisë është:

Z. Jurgen Vlashi, me numer identifikimi J90130043Q, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID 033989843, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, emëruar ne këtë detyrë për një afat **5 vjeçar** me të drejtë ripërritje.

Neni 10
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themeli dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themeli, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republiken e Shqipërisë.

Neni 11
Dispozita perfundimitare

Ky akt themeli u redaktua ne 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përbajtje dhe vlera te njëjtë juridike.

Akti i mësiperm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga Ortak themelues të shoqërisë tregtare "**Magic Car Wash**" shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ORTAK THEMELUES

The image shows two handwritten signatures in blue ink. The signature on the left is "Jurgen" and the signature on the right is "Vlashi". Below these signatures is a stylized, cursive line that appears to be a signature for "Ortak Themelues".